

Titulli i lëndës: NORMË E SHQIPES SË SHKRUAR

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë, Dega e Gjuhës Shqipe
Titulli i lëndës:	Normë e shqipes së shkruar
Niveli:	BA (Baçelor)
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti I Semestri I
Numri i orëve në javë:	2+4
Kreditë ECTS:	6 ECTS
Koha / Vendi:	E enjte, 13:00-14:30 Salla 76
Orari i konsultimeve:	E martë, 12:00-13:00 zyra 68 E mërkurë, 12:00-13:00 zyra 68 E enjte, 12:00-13:00 zyra 68
Mësimdhënësi:	Prof. ass. dr. Shpëtim Elezi
Të dhënat kontaktuese:	shpetim.elezi@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	Lënda Norma e shqipes së shkruar ofron bazën e drejtshkrimit të gjuhës standarde shqipe, siç janë parimet dhe rregullat e drejtshkrimit të saj. Ky kurs u ofron studentëve shpjegimet dhe sqarimet e nevojshme teorike lidhur me përvetësimin dhe aplikimin në praktikë të rregullave të drejtshkrimit të gjuhës standarde shqipe. Ligjërimi me shkrim është i nevojshëm për të gjithë për nevoja akademike dhe profesionale, andaj për të shkruar korrekt dhe pa gabime drejtshkrimore është e domosdoshme që të mësohen rregullat drejtshkrimore të shqipes standarde, qofshin ato të natyrës fonetike, morfologjike, sintaksore dhe leksikore. Kursi përfshin edhe përdorimin korrekt të shenjave të pikësimit.
Qëllimet e lëndës:	Ky kurs ka për qëllim ngritjen e nivelit dhe kulturës së shkrimit të studentëve në shqipen standarde lidhur me planifikimin dhe hartimin e shkrimit, përdorimin korrekt të normës gjuhësore në të gjitha rrafshet dhe nivelet e gjuhës, si në aspektin drejtshkrimor, fonetik, gramatikor, leksikor, stilistik dhe të shenjave të pikësimit. Po ashtu kursi ka për qëllim që studenti të arrijë të identifikojë, të korrigojë, të shpjegojë e të zbatojë rregullat drejtshkrimore të shqipes standarde, si dhe të hartojë tekste të ndryshme (ese, seminare, diploma, hulumtime etj.) në përputhje me këto rregulla gjuhësore dhe teknika të shkrimit.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi, studenti: <ul style="list-style-type: none">• Identifikon gabimet drejtshkrimore e gjuhësore në tekste;• Shpjegon rregullat drejtshkrimore dhe gjuhësore në përgjithësi;• Zbaton rregullat drejtshkrimore e gjuhësore në shkrime;• Analizon rregullat duke u bazuar në parime të ndryshme të drejtshkrimit;

- Harton tekste në përputhje me rregullat gjuhësore dhe me teknikat e të shkruarit;
- Rekomandon lidhur me rregullat drejtshkrimore e gjuhësore.

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë / Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	22.5
Ushtrime	4	15	45
Përgatitje për test intermediar	3	4	12
Konsultime me mësimdhënësin	10 min	15	2.5
Testi, punimi i seminarit	2	2	4
Detyrë shtëpie	1	15	15
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja për provimin final	3	4	12
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	2	4
Projektet, prezantimet, etj.	10 min	15	2.5
Totali			149.5 orë 149.5:25=5.98 6 ECTS

Metodat e mësimdhënies: Mësimi realizohet nëpërmjet ligjëratave që ofrojnë bazën teorike dhe ushtrimeve që ofrojnë bazën praktike në klasë si dhe me detyra të vazhdueshme në shtëpi. Mësimdhënia gjatë ligjëratave do të jetë e organizuar nëpërmjet një diskutimi interaktiv për tema të caktuara. Gjatë ushtrimeve mësimdhënia është e orientuar nga studentët, ndërsa mësimdhënësi e kontrollon rrjedhën e orës dhe të shpjegimit të koncepteve të diskutueshme dhe të paqarta. Studentët kanë punime seminari e punime me shkrim të kryera në mënyrë të pavarur e individuale, por bëjnë edhe punë në çift e në grupe, shkrime tekstesh e hulumtime, si dhe përmes projekteve e prezantimeve, duke nxitur debate e diskutime.

Metodat e vlerësimit: Kufiri i kalueshmërisë është 61%.
 - Vijueshmëria dhe angazhimi (L+U)10%
 - Detyrat në klasë e në shtëpi (U) 10%
 - Kolokuiumi I 40%
 - Kolokuiumi II 40%
 Gjithsej 100%: 61-68% (nota 6), 69-76 (7), 77-84 (8), 85-93 (9), 94-100 (10).
 Shënim. Në çdo testim (kolokuium a provim), pyetja e parë, që është një tekst me numër të caktuar gabimesh drejtshkrimore, ka karakter eliminues.

Literatura primare:

1. Drejtshkrimi i gjuhës shqipe. Tiranë: ASHSH, 1973. (Shkarko në: <https://www.shkenca.org/index.php/gjuhe-shqipe/18-drejtshkrimi/51-drejtshkrimi-i-gjuhes-shqipe>)
2. Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe. Tiranë: ASHSH, 1976.
3. Rregullat e pikësimit në gjuhën shqipe. Tiranë: ASHSH, 2002.
4. Materialet nga ligjëratat në klasë.

Literatura shtesë:

1. A. Dhrimo, R. Memushaj, Fjalor drejtshkrimor i gjuhës shqipe, Tiranë: Infobotues, 2011.
2. ASHAK, Shqipja standarde sot. Prishtinë, 2023.
3. Bardh Rugova, Ideologjia e gabimit gjuhësor, Prishtinë: ASHAK, 2021.
4. Fadil Sulejmani, Praktikum i gjuhës shqipe, Prishtinë, 1981
5. Fjalor i shqipes së sotme, Tiranë: ASHSH, 2006. Në: www.fjalorthi.com
6. Gramatika e gjuhës shqipe, 1, 2, Tiranë: ASHSH, 2002.
7. Gjovalin Shkurtaj, Kultura e gjuhës, Tiranë, 2006.

8. Gjovalin Shkurtaç, Si të shkruajmë shqip? Tiranë: Toena, 2008.
9. Gjuha jonë (revistë e botuar nga IGJL në Tiranë).
10. Gjuha letrare për të gjithë, Tiranë, 1976.
11. Gjuha shqipe (revistë e botuar nga IA në Prishtinë).
12. Isa Bajçinca, Shqipja standarde dhe probleme rreth saj. Prishtinë, 2016.
13. Kongresi i drejtshkrimit të gjuhës shqipe. Tiranë: ASHSH, 1973.
14. Kristina Jorgaqi, Sportel i hapur i shqipes, Tiranë: Ombra GVG, 2008.
15. Propozime për drejtshkrimin (1976-2014), I, II. Shkup, 2022.
16. Rami Memushaj, Shqipja standarde, Tiranë: Toena, 2004.
17. Rexhep Ismajli, Drejtshkrimet e shqipes, Prishtinë: ASHAK, 2005.
18. Rexhep Ismajli, Gjuhë standarde dhe histori identitetesh, Tiranë: ASHSH, 2005.
19. Rregullat e drejtshkrimit të shqipes (Projekt). Prishtinë: UP, 1967.
20. Shpëtim Elezi, Çështja e shumësit me -nj, -inj, -enj në sistemin emëror të shqipes standarde. Në "Albanologji", nr. 2, IAP, Prishtinë, 2012.
21. Shpëtim Elezi, Përdorimi i shqipes standarde nga mësimdhënësit e ciklit fillor. Në "Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, nr. 34/1, Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë, 2015.
22. Shpëtim Elezi, Rreth thjeshtimit të rregullave në normën e shqipes standarde. Në: Shqipja standarde sot". Prishtinë: ASHAK, 2023.
23. U. Eco, Si bëhet një punim diplome. Tiranë: botime përpjekja, 1997.
24. Zijadin Munishi, Zgjedhimi i foljeve, Prishtinë: Artini, 2013.

Hartimi i planit mësimor

Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Procesi i të shkruarit; Planifikimi i shkrimit; Teksti; Paragrafi; Citimet dhe shënimet; Redaktimi dhe korrektimi
Java 2:	Historia e shkrimit; Historia shqipes standarde; Gjuha standarde shqipe; Nocionet <i>gjuhë standarde – gjuhë letrare</i> ; Veçoritë e shqipes standarde; Parimet dhe rregullat e drejtshkrimit të shqipes standarde; Zbatimi i tyre
Java 3:	Gjuha standarde dhe dialektet; Faktorë gjuhësorë dhe jashtëgjuhësorë me ndikim në përvetësimin dhe zbatimin e normës së shqipes së shkruar
Java 4:	Emri: gjinia, trajta, rasa dhe shumësi i emrave
Java 5:	Përemrat dhe përdorimi i tyre
Java 6:	Folja dhe shkrimi i formave foljore
Java 7:	Çështje sintaksore: Rendi dhe përshtatja e gjymtyrëve në fjali; Kalket sintaksore (<i>KOLOKUIUMI 1</i>)
Java 8:	Drejtshkrimi i zanoreve, Grupe dhe takime zanoresh
Java 9:	Drejtshkrimi i zanores ë: e theksuar, e patheksuar (paratheksore, pastheksore: jofundore e fundore)
Java 10:	Shkrimi i bashkëtingëlloreve; Grupe dhe takime bashkëtingëlloresh
Java 11:	Përdorimi i shkronjës së madhe
Java 12:	Shkrimi i fjalëve njësh, ndaras dhe me vizë në mes
Java 13:	Përdorimi dhe drejtshkrimi i nyjave të përparme, i pjesëzave dhe i parafjalëve të përsëritura
Java 14:	Shenjat e pikësimit; Apostrofi; Shkrimi i datave
Java 15:	Përdorimi i leksikut (<i>KOLOKUIUMI 2</i>)

Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Studentët janë të obliguar t'i vijnë me rregull ligjëratat dhe ushtrimet. Nuk lejohen më shumë se tri mungesa gjatë semestrit. Detyrat që dalin nga këto orë mësimi janë të obligueshme dhe pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të studentit. Plagjiatura dhe kopjimi në provime dhe punimet e tjera me shkrim janë të dënueshme në përputhje me masave disiplinore që parashihen në rregulloret e UP-së. Sjellja e mësimdhënësit dhe e studentëve bazohet në kodin e mirësjelljes dhe të etikës në kuadër të UP-së.